

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial**  
**Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 1.27 të Ligjit Nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 83 publikuar me dt. 29 tetor 2010) si dhe nenin 13 parag. 6 të Ligjit Nr. 05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit (Gazeta Zyrtare, Nr.17, publikuar me 30 qershor 2015), në mbledhjen e mbajtur me 01 dhjetor 2015 miraton:

**R R E G U L L O R E NR.06/2015**

**PËR NDARJEN E LENDËVE**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e sistemit të ndarjes së lëndëve në institucionin e Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës.
2. Dispozitave të kësaj rregullore iu përmbahen të gjithë kryeprokurorët, prokurorët e shtetit dhe stafi administrativ i të gjitha prokurorive, në procesin e ndarjes së lëndëve.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimet si më poshtë:

**KPK**.....Këshilli Prokurorial i Kosovës;

**KPRK**.....Kodi Penal i Republikës së Kosovës;

**KPPK**.....Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës;

**Lëndë urgjente**.....lëndët të cilat janë të regjistruara si lëndë me urgjencë në shkrimoren e prokurorisë;

**Sistemi rotativ**.....ndarjen e lëndëve të secili prokuror në mënyrë të barabartë;

**Sistemi i rastësisë**.....ndarjen e lëndëve sipas radhës bazuar në departamente, kapitujt e KPRK-së dhe numrin e prokurorëve;

#### **Neni 4 Sistemi i ndarjes së lëndëve**

Ndarja e lëndëve në secilën prokurori bëhet sipas sistemit të rastësisë, bazuar në kriteret objektive.

#### **Neni 5 Ndarja e lëndëve**

5.1. Ndarja e lëndëve prokurorëve të shtetit bëhet sipas sistemit të rastësisë.

5.2. Të gjitha lëndët e pranuar nga personeli i administratës së Prokurorit të Shtetit, sipas radhës së arritjes i dërgohen kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse.

5.3. Kryeprokurori i prokurorisë pas pranimit të lëndëve nga personeli përgjegjës i administratës së prokurorisë përkatëse grupon lëndët sipas departamenteve, kapitujve të KPRK-së, natyrës dhe peshës së veprës penale dhe numrit të prokurorëve në prokurorinë përkatëse. Grupimi i lëndëve bëhet duke përcaktuar një radhë rastësore të regjistrimit të lëndës në mënyrë të barabartë.

5.4. Me barazi në ndarjet e lëndëve do të kuptohet: ndarja në numër të barabartë mes prokurorëve, të lëndëve të ardhura për short, pavarësisht nga ngarkesa individuale e çdo prokurori në kohën e hedhjes së shortit.

5.5. Lëndët e grupuara sipas paragrafit 5.3 të këtij neni, Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, ua ndan prokurorëve përmes shortit.

5.5.1. Shorti organizohet nga Kryeprokurori i Prokurorisë përkatëse, duke ftuar të gjithë Prokurorët t'a tërheqin numrin e vendosur në grupe të lëndëve.

5.5.2. Mbi çdo grumbull të lëndëve vihet një procesverbal në të cilin përshkruhet numri dhe lloji i lëndëve të cilat do të tërhiqen nga prokurori të cilit i bie shorti.

5.5.3. Në grupin e lëndëve që i nënshtrohen shortit caktohen jo më pak se dy lëndë.

5.5.4. Në rastet kur ka më pak grupe lëndësh se sa prokuror, atëherë Kryeprokurori cakton shortin sipas radhës së prokurorëve sipas numrit rendor, duke respektuar parimin e barazisë sipas parag. 5.4 të këtij neni.



5.6. Ndarja përmes shortit nga Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse duhet të jetë transparente dhe të bëhet në datë dhe orarin e caktuar paraprakisht.

5.7. Administrimin e procesit për ndarjen e lëndëve e udhëheqë Kryeprokurori ose i autorizuari i prokurorisë përkatëse.

5.7. Në momentin e aplikimit të sistemit elektronik të menaxhimit të rasteve, ndarja e lëndëve do të bëhet përmes këtij sistemi.

## **Neni 6**

### **Procedura e veçantë e ndarjes së lëndëve**

6.1. Lënda e natyrës urgjente e cila për nga afati kërkon vendosje të shpejtë ndahet tek prokurori i çështjes nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, ose nga përgjegjësi i departamentit.

6.2. Këto lëndë nuk i nënshtrohen shortit sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje, por duhet të respektohet sistemi rotativ në bazë të sistemit të ndarjes së lëndëve tek prokurori.

6.3 Prokuroret e dekretuar me mandat fillestar dhe prokurorët të cilët avancohen nga departamenti i përgjithshëm në departamentin për krime të rënda dhe departamentin për të mitur, do të ngarkohen vetëm me lëndë të reja.

## **Neni 7**

### **Rastet të cilat nuk i nënshtrohen ndarjes së lëndëve**

Departamentet e prokurorive të cilat nuk kanë më tepër se një prokuror ku duhen të ndahen lëndët, nuk i nënshtrohen procesit të ndarjes së lëndëve.

## **Neni 8**

### **Ndarja e lëndëve të pranuar gjatë kujdestarisë**

8.1. Prokurori kujdestar për të gjitha lëndët për të cilat ka bërë kërkesë në gjykatë për caktimin e ndonjë mase për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë, do ta mbajë lëndën deri në përfundimin e saj, përjashtimisht të rasteve kur lënda bie në departamentin tjetër.

8.2. Në rastet kur prokurori gjatë kujdestarisë, bën kërkesë për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, përkatësisht ka bërë kërkesë për masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit sipas KPPK-së të njëjtit do t'i takojë lënda deri në përfundim të rastit, pavarësisht nëse bën kërkesë për ndonjë masë për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë.

8.3. Numri i rasteve të pranuar gjatë kujdestarisë sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni zbritet nga numri i rasteve të caktuara me sistemin e rastësisë.

8.4. Në rastet kur i dyshuari lëshohet në procedurë të rregullt, lënda i ndahet prokurorëve sipas sistemit të paraparë në paragrafin 5 të nenit 5 të kësaj Rregullore.


8.5. Kur lënda gjatë kujdestarisë dërgohet në kompetencë të departamentit tjetër, me atë lëndë ngarkohet prokurori i cili është kujdestar ose në radhë sipas sistemit të rastësisë.

### **Neni 9** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe fillon së zbatuari nga 1 janar 2016.

Prishtinë, më 01 dhjetor 2015

Këshilli Prokurorial i Kosovës  
Kryesues Aleksandër Lumezi



---

